



Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 4 të Ligjit për Hoçën e Madhe Nr. 04/L-62, Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 26 dhjetor 2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT PËR FSHATIN HOÇË E MADHE

- I. Për anëtarë të Komisionit Ad-hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, zgjidhen:
 1. Negovan Mavric, nga Hoca e Madhe
 2. Natalija Patrnogic, nga Hoca e Madhe
 3. Jovan Simic, Kisha ortodokse Hoça e Madhe
 4. Rexhep Oruçi, anëtar i Kuvendit
 5. Arsim Kastrati, anëtar i Kuvendit
- II. Detyrat e Komisionit Ad-hoc janë: që të bëjë selektimin dhe zgjedhjen e kandidatëve që kanë konkurruar për anëtar të Këshillit, në afat prej 15 ditëve prej ditës së kalimit të afatit për aplikim si dhe të njëjtit t'i dërgojë Kuvendit komunal për aprovim.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Ekzekutivi i komunës.
- IV. Me vendim të njoftohen anëtarët e Komisionit ad-hoc dhe arkivi i komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit në Kuvend.

01 Nr. 4860
Rahovec, 26. 12. 2014

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani

